

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Homazh për regjisorin e madh italian Luchino Visconti në edicionin e 24-t të TIFF
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/homazh-per-regjisorin-e-madh-italian-luchino-visconti-ne-edicionin-e-24--i586910
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:35:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:34:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	03a7f1a1be35dfbdc72808096d9eab4e39f126223607f6d1b30ef6a2884f1998
TEKSTI	b691ce3b5031ec9eaa476bd88b72c4ed537ea70c7af47c5389c5382913de144f
PAMJA	2efc5dc575af02b359231a2d0a373ee4be87e269e23fee9a7732f75615fd80a2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f4db0611135036f6178eeacb2e63c81eba4163c347f1bc038d69ec33e986711f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f4db0611135036f6178eeacb2e63c81eba4163c347f1bc038d69ec33e986711f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e [Homazh per regjisorin e madh italian Luchino Visconti ne edicionin e 24-t te TIFF](#) Hoxha takim me perfaqesuesin e ri te OBSH-se ne Shqiperi: Partneritet per zhvillimin e fundit

Homazh për regjisorin e madh italian Luchino Visconti në edicionin e 24-t të TIFF



18 Shtator 2026, 16:34Kulturë TEMA



Vepra e një prej emrave më të rëndësishëm të kinemasë italiane, Luchino Visconti, do të jetë në fokus të edicionit të 24-t të Tirana International Film Festival (TIFF), përmes një programi të veçantë (RetrospecTIFF) homazh kushtuar regjisorit të njohur.

Publiku shqiptar do të ketë mundësinë të rizbulojë krijimtarinë e Visconti-t përmes tre prej filmave të tij, të cilët sjellin në ekran tema të shoqërisë, pasioneve, konflikteve dhe brishtësisë njerëzore.

Programi hapet më 22 shtator 2026, në orën 17:30, në kinema "Millennium", me filmin "Ossessione" (1943), vepra e parë e gjatë e regjisorit dhe një prej titujve që shënoi një moment të rëndësishëm në zhvillimin e kinemasë italiane.

Një ditë më pas, më 23 shtator, në orën 20:00, në kinema "Agimi", do të shfaqet "Rocco e i suoi fratelli" (1960), dramë familjare dhe shoqërore që trajton përplasjet, ndryshimet dhe vështirësitë e një familjeje të ardhur nga jugu i Italisë në Milano.

Programi përmbyllet më 26 shtator, në orën 20:30, sërisht në kinema "Millennium", me "L'innocente" (1976), filmi i fundit i Visconti-t, i bazuar në romanin e Gabriele D'Annunzio-s.

Përmes këtyre tri veprave, TIFF në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës në Tiranë, sjell në kryeqytet një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së Luchino Visconti-t, duke i dhënë publikut mundësinë të rikthehet te një autor që ndërthurte në mënyrë të veçantë dimensionin estetik të filmit me portretizimin e shoqërisë dhe kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore.

Programi homazh për Visconti-n është një tjetër mundësi për të parë në ekranin e madh vepra që vijnë në ruajtje të rëndësishme të tyre artistike dhe të dëshmojnë forcën e kinemasë italiane. A.K./TemA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shqipëria merr pjesë në "Platforms Project"](#)

15:17 Kulturë

Skënder Gjinushi priti në takim zyrtar drejtorin e përgjithshëm të CIHEAM-Bari, dr. Biagio Di Terlizzi

13:15 Kulturë

[TIFF 2026 do të vijojë partneritetin me European Film Academy](#)

11:14 Kulturë

[Ansambli Kombëtar bëhet gati të nisë turin në Itali](#)

09:10 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.